

DEKALOGU I PRESIDENTIT EUROPIAN

4

**BUJAR  
OSMANI**

**PËRVOJË, NDERSHMËRI, PËRKUSHTIM!**

**President European!**







# **DEKALOGU I PRESIDENTIT EUROPIAN**

**BUJAR OSMANI**







# DEKALOGU I PRESIDENTIT EUROPIAN

## I. BAZAT E PROGRAMIT

1. Busulla e orientimit gjeostrategjik të vendit
2. Indi lidhës i narrativave etnike dhe politike
3. Roli i kreatorit të konsensusit shtetëror

## II. ZOTIME

1. BE 2030
  - A. Arritja e konsensusit për në BE
  - B. Hapja e kapitujve 2024
  - C. Maqedonia e Veriut vend anëtar i BE-së deri më 2030
  - Ç. Më shumë integrim para anëtarësimit
2. Zgjedhja e Presidentit në Kuvend, me Badenter.
3. Partneriteti dhe Dialogu Strategjik me ShBA-në
4. Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut
5. Bord ndërkombëtar SHBA, BE, NATO për certifikimin e të gjithë bartësve të funksioneve publike
6. Marrëveshja kornizë ekonomike
7. Politika e Jashtme
8. Plani shtetëror për perspektivën e të rinjve dhe mbajtjen e tyre në vend
9. Agjenda e Gjelbër dhe Siguria
10. Edukimi dhe inovacioni

## I. BAZAT E PROGRAMIT

# 1. Busulla e orientimit gjeostrategjik të vendit

Republika e Maqedonisë së Veriut tashmë katër vite është anëtare e plotfuqishme e NATO-s duke u integruar me sukses në sistemin e sigurisë dhe sistemin politik të Aleancës.

**Ky është një përfitim thelbësor. Shteti është shumë më i qëndrueshëm dhe më pak i ekspozuar ndaj kërcënimeve të jashtme të sigurisë, por edhe faktor më i rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare.**

Ky besim dhe ky autoritet i arritur tek aleatët, kontribuon që vendi dhe rajoni të jenë objektiv i një gare gjeopolitike që po zhvillohet në skenën globale. Republika e Maqedonisë së Veriut është nën kërcënim të fuqishëm të të ashtuquajturave qendra të forcave alternative, të udhëhequra nga ndikimi rus, por jo edhe të kufizuara aty, interesat e të cilave nuk përkojnë me interesat strategjike të vendit.

Federata Ruse, përveç kundërshtimit të integritetit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në NATO, tashmë edhe zyrtarisht e ka vendosur zgjerimin e Bashkimit European në rajonin tonë, si kërcënim për interesat nacionale të Rosisë, për më tepër, duke u rreshtuar me vendet demokratike në përkrahje të hapur ndaj Ukrainës dhe kundër agresionit të Rosisë, Maqedonia e Veriut edhe zyrtarisht u përfshi si vend armik në listën e Kremlinit. Ndikimi hibrid, i cili edhe tani po ndjehet, vetëm do të intensifikohet në funksion të interesave ruse për destabilizimin e gjithë rajonit.

Prandaj, roli i parë dhe më i rëndësishëm që do të ketë Presidenti i vendit është ruajtja e kursit euroatlantik të vendit, **dhe që t'i thuhet JO Rosisë dhe ndikimit të saj në rajon,** duke e përforcuar qëndrueshmërinë e vendit ndaj ndikimeve të jashtme malinje dhe të dëmshme.





*Ky është një përfitim thelbësor. Shteti është shumë më i qëndrueshëm dhe më pak i ekspozuar ndaj kërcënimeve të jashtme të sigurisë, **por edhe faktor më i rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare.***





# 2. Indi lidhës i narrativave etnike dhe politike

**Që nga pavarësia, këtu e 30 vjet më parë, vendi ka qenë në një krizë të vazhdueshme politike të shkaktuar nga mungesa e dialogut politik përgjatë disa diagonaleve të diskursit politik.**

- E para është diagonalja etnike, e cila për shumë vite ishte burim konflikti mes komuniteteve të ndryshme në vend, duke u bërë pengesë për përparimin thelbësor të shoqërisë. Modeli i Demokracisë Funktionale Multietnike, i inkorporuar plotësisht në frymën e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, përbën burimin kyç të stabilitetit të vendit.

Ruajtja e një shoqërie funksionale shumetnike përfaqëson interesin kryesor shtetëror dhe të sigurisë së vendit, mbi të cilat themele qëndron stabiliteti dhe siguria jonë afatgjatë. Andaj edhe pritshmëritë janë që të gjitha goditjet nga jashtë të jenë të orientuara drejt lëkundjes së themeleve të këtij modeli, gjë që do të prekte edhe shtyllat që e ruajnë qëndrueshmërinë e vendit në ballafaqim me sfidat.

- E dyta është diagonalja politike, në kuadër të etniteteve. Çdo demokraci e zhvilluar, përkujdeset për dialogun e brendshëm politik, veçmas kur është fjala për ndërtimin e konsensusit të gjerë rreth çështjeve kyçe. Nga aspekti i suksesit të dialogut politik, mund të thuhet se gjatë gjithë periudhës së ekzistimit të saj, Republika e Maqedonisë së Veriut është vend në krizë të vazhdueshme politike. Sado që të përpiqemi, nuk mund të gjejmë një periudhë të caktuar kur vendi ka arritur konsensus të brendshëm politik për disa nga çështjet kyçe, pa qenë ky një përjashtim i arritur përmes ndikimit të fuqishëm të miqve tanë ndërkombëtarë.

Roli i Presidentit të shtetit është që ta ndërpresë këtë "qark vicioz" akuzash të ndërsjella dhe të **vendos mekanizma të qartë dhe preciz përmes të cilëve do të realizohet dialogu thelbësor politik në vend** duke lënë anash agjendat ditore partiake nga çështjet me interes të lartë shtetëror.

# 3. Roli i kreatorit të konsensusit shtetëror

**Në mënyrë përkatëse me sistemin kompleks të demokracisë parlamentare, veçanërisht në mjediset shumetnike, siç jemi ne, Presidenti ka një rol të rëndësishëm ndërlidhës në shoqëri.**

Kompetencat ekzekutive të Presidentit dallojnë nga ato të Pushtetit ekzekutiv. Ato mbivendosen në disa fusha, para së gjithash rreth politikës së jashtme, sigurisë shtetërore, si dhe ndaj pushteteve të tjera në vend – në gjyqësor, legjislativ dhe kontroll civil.

Kjo nuk është e rastësishme, sepse përmes kësaj ndarjeje kompetencash, Presidenti merr rolin e katalizatorit të proceseve politike, me qëllim të parandalimit të konflikteve politike, de-eskalimit të përplasjeve të brendshme dhe merr rolin e gardianit të integritetit të jashtëm të vendit. Duke qenë i lirë nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, përgjegjësia politike e Presidentit qëndron në shkathhtësinë e

krijimit të aleancave, për të ndërmjetësuar dhe për të krijuar konsensus në shtet si dhe për të siguruar stabilitet dhe parashikueshmëri në garën politike.

Presidenti është garantues **i tri marrëveshjeve bazike** mbi të cilat ngritet demokracia dhe pozicionimi ndërkombëtar i Maqedonisë së Veriut.

- **Marrëveshjes Kornizë të Ohrit**
- **Marrëveshjes së Prespës me Republikën e Greqisë**
- **Marrëveshjes për Bashkëpunim dhe Miqësi me Republikën e Bullgarisë**







*Presidenti është garantues i tri marrëveshjeve  
**bazike** mbi të cilat ngritet demokracia dhe  
pozicionimi ndërkombëtar i  
Maqedonisë së Veriut.*





# 1. BE 2030

**Bashkimi European së fundmi mori vendimin për fillimin e negociatave me Bosnjën dhe Hercegovinën. Progres në integrimin european është shënuar edhe në Ukrainë dhe Moldavi, ndërsa paraprakisht, negociatat thelbësore i filluan Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.**

Vetë përfaqësuesit e Unionit, por edhe të vendeve anëtare kyçe, theksojnë se çështja e integritit të vendeve kandidate paraqet çështje sigurie e politike, dhe jo çështje tekniko-burokratike apo ekonomike.

Që këtu edhe është krijuar kjo dritare e re e mundësive, padyshim si pasojë e krizës së sigurisë nga agresioni rus në Ukrainë. Kjo dritare, e ka zanafillën e vet në fillimin e negociatave për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Nga ky këndvështrim, mund të pritet edhe përmbyllja e valës së re, si rrjedhojë e dinamikave të reja gjeopolitike.

## A. Arritja e konsensusit për në BE

Hapja e kapitujve nënkupton edhe fokusim të aparatit administrativo-shtetëror ndaj reformave themelore dhe përshtatjen e plotë të shtetit dhe shoqërisë me rregullat, standardet dhe vlerat e Bashkimit European. Ky është një proces në të cilin përfshihen të gjithë aktorët e shoqërisë, institucionet e pavarura, sektori civil, ai akademik, biznesi, të rinjtë etj.

Në shumë vendet tona mike, të cilat tashmë janë anëtare të Unionit, ky proces konsiderohet si një nga periudhat më të bukura, kur vendi përjeton progresin më të madh, duke shënuar konvergjencë në të gjitha fushat drejtë standardeve dhe vlerave të Bashkimit European. Kjo është një periudhë e reformave thelbësore, e progresit të rëndësishëm infrastrukturor, progresit të rëndësishëm ekonomik; periudhë e vendosjes së sistemit shëndetësor efikas dhe funksional; e progresit të fuqishëm në arsim; progresit të jashtëzakonshëm ekonomik në të gjitha parametrat, nga rritja e produktit bruto, tek rritja e të ardhurave, pagave, bizneseve etj.

Suksesi për të nxjerrë maksimumin nga ky proces varet nga aftësia e krijimit të një konsensusi mbipartiak dhe shtetëror për çështjen e integritit european. Ndaj, rolin kyç në këtë proces do ta ketë Presidenti, dhe varësisht nga shkathtësia e tij për të krijuar një bazament të favorshëm për ndërtim të konsensusit, do të varet edhe suksesi i këtij procesi. Andaj, si President do të angazhohem për nënshkrimin e një traktati mes të gjitha forcave proeuropiane në vend dhe formimin e



## II. Zotime

një trupi bashkërendues mbipartiak, si garantues i konsensusit për Europë.

### B. Hapja e kapitujve 2024

Nuk guxojmë ta humbasim këtë dritare mundësish, dhe jo pas pak vitesh, por menjëherë pas zgjedhjeve, duhet t'i qasemi miratimit të ndryshimeve kushtetuese me qëllim që t'i hapim klasterët dhe kapitujt e negociatave. Me këtë do ta shfrytëzojmë shansin e fundit për të mos e lëshuar këtë momentum historik.

### C. Maqedonia e Veriut vend anëtar i BE-së deri më 2030

Procesi i hapjes së kapitujve duhet të fillojë këtë vit, dhe duke pasur parasysh progresin e deritanishëm në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asociimit, procesi i mbylljes së kapitujve nuk duhet të zgjasë më shumë se pesë vjet.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka më shumë se 40% harmonizim të legjisllacionit të saj të brendshëm me acquis të BE-së, ka 100% harmonizim me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së, ka lidhje të fortë institucionale që nga menaxhimi i përbashkët i kufijve, në kuadër të Frontex-it, përmes regjimit të vendosur pa viza, e deri në integrimin e



sistemeve financiare dhe të lidhshmërisë me mekanizmat dhe rrjetet e shumta funksionale europiane.

Prandaj, si President do të të krijoj mbështetje të veçantë politike për Ekipin e ardhshëm Negociator, me qëllim të zhvillimit të shpejtë të negociatave dhe implementimit të reformave thelbësore për anëtarësimin e vendit deri në vitin 2030. Do të angazhohem që Presidenca të përfshihet drejtpërdrejtë në ekipet negociatore përmes delegimit të ekspertëve të fushave përkatëse.



#### **Ç. Më shumë integrim para anëtarësismit**

Për dallim nga proceset e mëparshme negociatore, vendet që aktualisht janë në negociata do ta shfrytëzojnë formën e re të kornizës negociatore, për të cilën Unioni ka vendosur mekanizëm të veçantë për integrim më të fuqishëm që në fazë të para-anëtarësismit të vendeve në Union.

Kjo paraqet një mundësi të papërsëritshme që qytetarët në vitet në vijim t'i ndjejnë përfitimet e integritimit në Union edhe para anëtarësismit zyrtar. Me këtë parashihet rritje e ndjeshme e fondeve,

të cilat paraqesin investim bazik për zbatim të suksesshëm të reformave.

Presidenti do të sigurojë mbështetje politike për prioritetet e veçanta për institucionet që janë përgjegjëse për implementimin e këtyre mundësive. Para së gjithash, këto janë institucionet përgjegjëse për hartëzimin, shpërndarjen dhe kontrollin e përdorimit të fondeve europiane; institucionet përgjegjëse për implementimin e reformave, struktura negociuese dhe veprues të tjerë.

Presidenti do t'i prijë këtij procesi konform kompetencave të tij, si katalizator i zhvillimeve shoqërore, duke siguruar rrjedhë politike pa pengesa për administratën profesionale.





14

Parlamente 141



# 2. Zgjedhja e Presidentit në Kuvend, me Badinter.

**Zgjedhja e Presidentit në mënyrë të drejtpërdrejtë, më shumë i përshtatet sistemit presidencial të vendeve kushtetuese. Veçanërisht ky model është i papërshtatshëm për shtetet multietnike dhe është në kundërshtim me frymën e Marrëveshjes së Ohrit, e cila parashih mekanizma mbrojtëse nga mbivotimi.**

Prandaj, në tridhjetë vitet e fundit Presidenti në vend se të luajë rolin e faktorit koheziv në shtet, ka qenë burim i eskalimeve dhe polarizimeve të vazhdueshme nga të cilat vështirë jemi rikuperuar.

Presidenti do të iniciojë ndryshime kushtetuese me qëllim të zgjedhjes së Presidentit në Kuvend me shumicë të dyfishtë-Badinter, me çka do të arrihet gjithpërfshirje politike dhe etnike që do të garantojë se Presidenti i shtetit do të ketë autoritet të mjaftueshëm për të luajtur rolin e kreatorit të konsensusit etnik, politik dhe shtetëror.



# 3. Partneriteti dhe Dialogu Strategjik me ShBA

**Forcimi i bashkëpunimit në të gjitha nivelet dhe fushat me partnerin kryesor strategjik – Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si mbështetësi më i madh i pavarësisë dhe stabilitetit të vendit tonë:**

- Bashkëpunimi në fushën e sigurisë
- Sundimi i ligjit
- Bashkëpunimi ekonomik dhe tregtar
- Regjimi i vizave
- Bashkëpunimi kulturor

Ngritja e dialogut strategjik në nivel të presidentëve të shteteve.











***Sigurimi i të paktën 2% të prodhimit të brendshëm bruto për financimin e Mbrojtjes, në përputhje me vendimet e NATO-s nga samiti i Uellsit dhe Vilniusit.***

# 4. Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut

**Përmirësimi i kushteve në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, pajisja dhe funksionimi i saj sipas standardeve të NATO-s.**

Sigurimi i të paktën 2% të prodhimit të brendshëm bruto për financimin e Mbrojtjes, në përputhje me vendimet e NATO-s nga samiti i Uellsit dhe Vilniusit.

Gatishmëria teknike dhe taktike e Armatës përballë kërcënimit të sigurisë ndaj rajonit nga politika ekspansioniste e Federatës Ruse.

Gatishmëri për t'u përballur me të gjitha sulmet hibride.

Përfaqësimi i drejtë i të gjithë qytetarëve brenda kuadrit të rregullt të eprorëve të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

# 5. Bord ndërkombëtar SHBA, BE, NATO për certifikimin e të gjithë bartësve të funksioneve publike

**Një prej sfidave kryesore të vendit është përballja me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Iniciativat e shumta për reforma në sistemin gjyqësor nuk e arritën qëllimin final.**

Presidenti do të mundësojë krijimin e kushteve për veting të plotë të sistemit politik dhe të drejtësisë. Me hapjen e klasterit të parë, hapen edhe kapitujt e parë 23 dhe 24 të dedikuar për reformim të plotë të sistemit gjyqësor dhe vendosjen e sistemit efikas për sundimin e së drejtës. Presidenti do ta shfrytëzojë këtë mundësi që të sigurojë inkorporim të vetingut për gjithë sistemin, duke i përfshirë të gjithë bartësit e funksioneve publike, me çka do të përforcohet besimi i qytetarëve ndaj institucioneve.

Në funksion të kësaj, Presidenti do të iniciojë një Bord të posaçëm Drejtues Ndërkombëtar, një organizëm ky që do të

mbështetet nga partnerët kryesorë ndërkombëtarë: SHBA, BE dhe NATO.

Dy parametrat kryesorë, sipas të cilëve do të kryhet vetingu, janë:

**a. Lidhshmëria me Rusinë, si një kërcënim kyç i sigurisë për vendin që rrënon drejtpërdrejt stabilitetin sistemor të vendit**

**b. Korrupsioni si sfidë kryesore për vendosjen e një sistemi të suksesshëm funksional të sundimit të ligjit**







# 6. Marrëveshja kornizë ekonomike

**Presidenti do të inicojë arritjen e konsensusit për një marrëveshje kornizë ekonomike.**

Negociatat për anëtarësim në BE ofrojnë mundësi për rritje të përsheptuar ekonomike dhe përafrim me standardet ekonomike të Unionit. Procesi i Berlinit, Plani i rritjes i BE-së, Iniciativa 8 dhe shumë të tjera, po ashtu, ofrojnë mundësi për hapjen e një cikli të ri të zhvillimit më të hovshëm ekonomik.

### Ekonomi e ndërlidhur

- Unifikimi i politikës së jashtme me politikën tregtare dhe investuese
- Marrëveshje ndërmjet Zyrës së Presidentit dhe Dhomave të Tregtisë për pjesëmarrje në të paktën pesë misione vjetore ekonomike të udhëhequra nga Presidenti.
- Trajektore e shpejtë për investime nga mërgimtarët tanë, si dhe masa nxitëse për kthimin e tyre në vend
- Marrëveshje me dhjetë universitetet më të mira të biznesit në botë për të dërgim të studentëve më të mirë me një bursë të plotë, me prioritet për kategorinë vulnerabël të qytetarëve.
- Tax-refund për tërheqjen e turistëve dhe rritjen e konsumit të tregut vendas
- Ambasadorë të biznesit të Maqedonisë së Veriut



## Ekonomi e drejtë

- Politika antimonopol dhe antidiskriminuese.
- Formimi i një komisioni për Investment Screening, veçanërisht në fushën e IT, Energjetikës, Prodhimit të dedikuar, minierave dhe infrastrukturës kritike.
- Digjitalizimi si mekanizëm për reduktimin e korrupsionit
- Tetë NOMAD Qendra presidenciale nëpër rajone të vendit.







# 7. Politika e Jashtme

**Maqedonia e Veriut është promovues dhe kontribues i paqes, stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal dhe multilateral.**

Vazhdimi i aktiviteteve për profesionalizimin e rrjetit diplomatik, duke garantuar standardin që 2/3 (dy të tretat) e ambasadorëve të jenë diplomatë të karrierës.

Përfaqësimi i drejtë i kuadrit në Përfaqësitë Diplomatiko-Konsullore.

Riorganizimi i Përfaqësive Diplomatiko-Konsullore sipas rolit të ri dhe nevojave të shtetit.

Anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara si anëtare jo e përhershme.

Vazhdimi i trashëgimisë së suksesshme me OSBE-në.



# 8. Plani shtetëror për perspektivën e të rinjve dhe mbajtjen e tyre në vend

**Progresi institucional dhe ekonomik duhet të paraqesë bazë për krijimin dhe afirmimin e politikave të veçanta për të rinjtë.**

Këto politika rinore do të fokusohen në **Krijimin e perspektivave** përmes mundësive të shtuara për arsim, por edhe përmes masave aktive për sipërmarrësi, start-up-e dhe përfshirje në rrjedhat bashkëkohore të biznesit, në mënyrë që të mbahet fokusi i të rinjve në aktivitetet dhe potencialet që i ofron vendi.

Edhe pse paraqesin pjesë të vetë procesit të negociatave, përkitazi me politikën e integritit të përforcuar para

anëtarësimit, Presidenti do të **formojë ekip** të posaçëm për krijimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave rinore të shtetit.

Në kabinetin e Presidentit, përmes një procesi të hapur dhe konkurrues dhe me përfshirjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të organizatave rinore, do të ketë një Këshilltar i cili do të angazhohet ekskluzivisht për këto çështje.









# 9. Agjenda e Gjelbër dhe Siguria

### **Promovimi, ngritja e vetëdijes së publikut dhe imponimi i Agjendës së Gjelbër si politikë dominuese bashkëkohore e vendit.**

Mbështetja e investimeve në energjinë e gjelbër, përmes rritjes së kapaciteteve për shfrytëzimin e energjisë diellore, energjisë së erës, si dhe mbështetjes së projekteve për shfrytëzimin e ujërave dhe gazifikimit, si burime energjike ekologjikisht të pranueshme, si përcaktim i përhershëm në reduktimin e përdorimit të karburanteve fosile me ndotje të lartë.

Presidenti do të formojë ekip të gjerë për Vlefshmëri

ekologjike, që do të sigurojë veting të projekteve me ndikim thelbësor në mjedisin jetësor.

Mbështetje të iniciativave për ndryshim të legjislaionit me çka do të mbrohen resurset natyrore dhe zonat e mbrojtura. Bashkëpunim aktiv në intervale të rregullta kohore me shoqatat civile ekologjike, për t'i identifikuar sfidat dhe nevojat më të rëndësishme ekologjike.



# 10. Edukimi dhe inovacioni


**Ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë dhe e pahamendshme midis cilësisë së arsimit, investimeve në universitete, qendra hulumtuese, dhe rritjes ekonomike të shtetit. Presidenti, në kuadër të kompetencave të tij, mund të angazhohet për reforma dhe një model arsimimi, i cili korrespondon me tendencat e reja të revolucionit teknologjik, të shkaktuar nga zhvillimi i inteligjencës artificiale.**

Në 10 vitet e ardhshme, mbi 40% e vendeve të punës do të zëvendësohen pjesërisht ose plotësisht për shkak të futjes së inteligjencës artificiale, në pozicione pune manual, por edhe në pozicione kreative dhe këshilluese.

Është një ndryshim që duhet ta ndjekim. Duhet të krijojmë staf që do t'u përgjigjet atyre nevojave dhe jo t'i shkollojmë studentët për punë që nesër, kur do të diplomojnë, nuk do të ekzistojnë!

Prandaj në procesin edukativo-arsimor do të propozoj një sërë masash që do të synojnë nxitjen e kreativitetit të nxënësve dhe studentëve duke përmirësuar teknikat e mësuesve dhe profesorëve; edukim dhe metodologji për të zgjidhur problemet reale përmes zhvillimit dhe inkurajimit të novatorizmit.

Prandaj do të propozoj rritje të buxhetit për arsimin dhe veçanërisht për veprimtarinë hulumtuese-shkencore, si dhe hapjen e detyrueshme të qendrave hulumtuese në çdo universitet. Ato do të kenë për detyrë të punojnë në tema dhe projekte bashkëkohore. Për këtë qëllim, planifikoj t'i shfrytëzoj edhe burimet e diasporës sonë të shumtë të kualifikuar. Ata të rinj, nxënës, studentë, postdiplomantë, që vitet e fundit kanë shkuar për të studiuar dhe punuar në qendrat më të zhvilluara shkencore europiane dhe botërore, mund të jenë një potencial i madh për vendin tonë. Një pjesë të këtyre të rinjve shteti e ndihmoi dhe financoi shkollimin e tyre në 50 universitetet më të mira në çdo fushë. Me një vizion dhe udhëheqje të qartë, ndryshimet dhe reformat janë të mundshme, janë edhe rruga më e shpejtë për të arritur standardin europian!













**FRONTI  
EUROPIAN**

